



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Ligji Nr. 02/L-68

**PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE
DHE NGA FATKEQËSITË E TJERA**

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Kreut 9.1.26 (a) dhe 5.5 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9) të datës 15 maj 2001, me qëllim të vendosjes së rregullave ligjore për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,

Miraton,

**LIGJIN PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE
DHE NGA FATKEQËSITË E TJERA**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1.1. Ky ligj përcakton dhe rregullon sistemin e mbrojtjes dhe të shpëtimit të njerëzve, të shtazëve, të pasurisë, të trashëgimisë së kulturës dhe të natyrës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

1.2. Qëllimi i mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera është: parandalimi dhe zvogëlimi i numrit të fatkeqësive dhe pengimi ose zvogëlimi i viktimave dhe i pasojave të tjera.

1.3. Qeveria dhe komunat organizojnë mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si sistem unik dhe i tërësishëm në Kosovë.

1.4. Sistemi i mbrojtjes dhe shpëtimit, nga paragrafi 3 i këtij neni, përmban programimin, planifikimin, organizimin, aftësimin, koordinimin, realizimin, mbikëqyrjen dhe financimin e masave dhe të aktiviteteve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 2
Detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe të shpëtimit
nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera

Detyrat bazë të sistemit të mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas këtij ligji, janë:

- i. zbulimi, përcjellja dhe hulumtimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- ii. parandalimi i fatkeqësive natyrore dhe i fatkeqësive të tjera,
- iii. vështrimi, lajmërimi, alarmimi dhe informimi i publikut për rreziqet e mundshme dhe dhënia e udhëzimeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- iv. arsimimi dhe aftësimi për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- v. organizimi i mbrojtjes dhe i gatishmërisë emergjente, si dhe mënyrat e tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- vi. vetëmbrojtja, vetë ndihma, ndihma reciproke (në vazhdim: mbrojtja personale dhe reciproke),
- vii. aktivizimi i forcave për mbrojtje dhe shpëtim dhe i mjeteve për realizimin e masave mbrojtëse,
- viii. shpëtimi dhe ndihma,
- ix. evitimi i pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, deri te sigurimi i kushteve elementare për jetë,
- x. mbikëqyrja e realizimit të rregullave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- xi. menaxhimi i ndihmave ndërkombëtare në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera.

Neni 3
Përkufizimet

Nocionet e përdorura në këtë ligj përkufizohen si vijon:

i. **Mbrojtja Civile** (në tekstin e mëtejshëm: MC), nënkupton pjesën e organizuar të sistemit të mbrojtjes nga fatkeqësitë e natyrës dhe nga fatkeqësitë e tjera. Mbrojtja Civile përbëhet nga organet udhëheqëse, njësitë dhe shërbimet, mjetet, objektet dhe pajisjet për mbrojtje, shpëtim dhe për ndihmë.

ii. **Gatishmëria emergjente** (në tekstin e mëtejshëm: GE) nënkupton planifikimin, organizimin e masave të duhura të reagimit emergjent nga autoritetet përkatëse qendrore dhe komunale, duke përfshirë edhe shërbimet emergjente për preventivë, zvogëlimin dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, në pronë ose në mjedis nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësi të tjera.

iii. **Fatkeqësia** nënkupton dukurinë e shkaktuar nga fuqitë e pakontrolluara natyrore dhe nga fuqi të tjera, që e rrezikojnë jetën apo shëndetin e njerëzve, të shtazëve si dhe pasurinë, që shkaktojnë dëme në trashëgiminë e kulturës dhe të natyrës si dhe në mjedis në atë masë që për kontroll dhe për mbizotërim është e nevojshme të përdoren masat, forcat dhe mjetet e posaçme.

iv. **Fatkeqësitë natyrore** nënkupton tërmetet, vërshimet, rrëshqitjet e borës, bora e madhe, era e fortë, breshri, akulli, thatësira, paraqitja masive e sëmundjeve ngjitëse te njerëzit, te shtazët dhe te bimët dhe fatkeqësi të tjera, që i shkakton natyra.

v. **Fatkeqësitë e tjera** nënkupton fatkeqësitë e mëdha në trafikun rrugor, ajror dhe hekurudhor, zjarret, fatkeqësitë në xeherore, shkatërrimi i digave dhe fatkeqësitë e tjera ekologjike dhe industriale, që i shkakton njeriu me punë dhe me sjellje, gjendja e jashtëzakonshme, emergjente, temperaturat e larta, kolapsi teknik i sistemeve energjike të furnizimit me rryme, telekomunikacioni dhe teknologjisë informative, aktet terroriste dhe mënyrat e tjera të rrezikimit masiv.

vi. **Masat parandaluese** kuptohen një kuadër masash që merren para ndodhjes së fatkeqësisë për shmangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.

vii. **Trashëgimi kulturore dhe e natyrës** nënkuptohen ndërtesat dhe pjesët e tyre, mjetet, sipërfaqet e tokës, vendbanimet ose pjesët e tyre, format e ndryshme në natyrë, që i ka krijuar njeriu dhe natyra si dhe trashëgimia tjetër e patundshme kulturore.

viii. **Angazhimi** nënkupton veprimet dhe aktivitetet me anë të të cilave forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë vihen në gjendje gatishmërie për realizimin e aktiviteteve në raste emergjente.

ix. **Aktivizimi** nënkupton veprimet, aktivitetet dhe mjetet për kërkim-shpëtim dhe mbrojtje.

x. **Forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë**, nënkupton forcat e njerëzve në dispozicion të ndërmarrjeve, komunës dhe të organeve qeveritare, të destinuara për mbrojtje, shpëtim dhe për ndihmë në raste fatkeqësish të natyrës dhe fatkeqësish të tjera.

xi. **Plani për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera**, nënkupton dokumentin për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësish të tjera, i hartuar në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë dhe të dokumenteve të tjera për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

xii. **Me vlerësim të rrezikshmërisë** nënkuptohet analiza sasimore dhe cilësore e natyrës dhe rrethanave të tjera për ndodhitë e mundshme nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera.

xiii. **Reagimi emergjent**, nënkupton veprimet e kryera në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera nga autoritetet qendrore, komunale dhe nga shërbimet emergjente për zvogëlimin dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, pronë ose në mjedis.

xiv. **Shërbimet emergjente**, nënkuptojnë shërbimet e siguruara nga: Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës, shërbimet emergjente mjekësore spitalore dhe paraspitalore të Kosovës, shërbimet komunale të zjarrfikës dhe të shpëtimit dhe shërbimet emergjente mjekësore komunale dhe OJQ-të përkatëse.

xv. **Organet qeveritare**, nënkuptojnë ministrinë dhe autoritetet e tjera kompetente qeveritare, të themeluara sipas Kornizës Kushtetuese dhe akteve të tjera juridike.

xvi. **Komiteti për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera**, nënkupton trup koordinues i kuvendit komunal dhe themelohet me qëllim të menaxhimit të situatave emergjente në komunë.

xvii. **Incidente të mëdha ose të rënda emergjente**, nënkuptohen incidentet ku janë kërkuar ose mund të kërkohen resurset shtesë emergjente pas mobilizimit të parë, apo ku ka rrezik të pashmangshëm për jetën dhe ku kanë ngjarë dëme gjithëpërfshirëse në pronë.

xviii. **Katastrofa**, nënkupton dukurinë e shkaktuar nga natyra ose nga njerëzit, çdo proces ose çdo ngjarje që ka mundësi të shkaktojë humbje në njerëz dhe dëme në të mira materiale.

xix. **Rreziku**, nënkupton një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera.

xx. **Riaftësimi**-nënkupton masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme në rajonin (territorin) e prekur nga fatkeqësia.

xxi. **DKMSH**- nënkupton drejtorinë komunale për mbrojtje dhe shpëtim.

xxii. **DME**- nënkupton Departamentin e menaxhimit të emergjencave.

xxiii. **SUAKE**- nënkupton Sistemin Unik të Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent.

II - SUBJEKTET PËR MBROJTJE NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE NGA FATKEQËSITË E TJERA

Neni 4

Mbrojtjen dhe shpëtimin nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në suaza të drejtave dhe të detyrave të përcaktuara me këtë ligj, e realizojnë:

- i. shërbimet publike për mbrojtje dhe shpëtim në nivelin qendror dhe komunal,
- ii. ndërmarrjet, institucionet dhe organizatat e tjera .
- iii. qytetarët, të organizuar në mënyrë vullnetare në shoqata, shoqata profesionale dhe në organizata të tjera joqeveritare (në vazhdim: shoqatat dhe organizatat e tjera joqeveritare),
- iv. qytetarët e Kosovës (në vazhdim: qytetarët).

Neni 5

Në kuadër të realizimit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, bashkëpunimi ndërkombëtar realizohet konform standardeve ndërkombëtare të aplikueshme në fuqi.

Neni 6

6.1. Të gjitha aktivitetet - veprimet e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, mbështeten dhe realizohen në pajtim me principet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe të së drejtës ndërkombëtare për mbrojtjen e njerëzve, të shtazëve, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit nga ndikimi i dëmshëm i fatkeqësive të natyrës dhe i fatkeqësive të tjera dhe obligimet ndërkombëtare që dalin nga to.

6.2. Mbrojtja dhe shpëtimi nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, kanë karakter humanitar.

III. TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E QYTETARËVE

Neni 7

7.1. Çdo qytetar ka të drejtë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

7.2. Në rast të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, shpëtimi dhe mbrojtja e jetës së qytetarit ka përparësi ndaj çdo aktiviteti tjetër për mbrojtje dhe për shpëtim.

Neni 8

Për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera qytetarët janë të obliguar që:

- i. të bashkëpunojnë me forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- ii. të japin mjete materiale (në vazhdim: obligim material),
- iii. të aftësohen dhe të përgatiten për mbrojtje personale dhe reciproke, si dhe
- iv. të realizojnë masat e parapara për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 9

9.1. Çdo person e ka për detyrë që personit, të cilit i kanoset rreziku për jetë, apo shëndet, t'i ndihmojë, nëse në atë mënyrë nuk e rrezikon jetën e vet.

9.2. Nëse personi nuk mund t'i ofrojë ndihmë në raste të tilla, menjëherë duhet ta lajmërojë qendrën për lajmërim apo shërbimin kompetent për shpëtim, ose në një mënyrë tjetër të kujdeset për ndihmë.

Neni 10

10.1. Qytetari i Kosovës është obligues i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, nëse nuk është i angazhuar në detyra të tjera obliguese, të përcaktuara me këtë ligj konform standardeve ndërkombëtare të aplikueshme në fuqi.

10.2. Obligimi i pjesëmarrjes në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë fillon nga mosha 18 vjeçare dhe zgjat deri në moshën 65 vjeçare për meshkujt, respektivisht 55 vjeç për femrat.

Neni 11

Nga detyrimi për të marrë pjesë në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë lirohen:

- i. qytetarët që për arsye shëndetësore nuk mund t'i kryejnë detyrat e parapara,
- ii. gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë nën 10 vjeç,
- iii. prindër të vetëm me një fëmijë nën 10 vjeç.

Neni 12

Në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në mënyrë vullnetare mund të marrin pjesë:

- i. meshkujt dhe femrat të moshës mbi 16 vjeç,
- ii. nënat me fëmijë të moshës nën 16 vjeç,
- iii. meshkujt dhe femrat, të cilëve u ka pushuar obligimi nga neni i 10-të.

Neni 13

13.1. Sistemimin e qytetarëve në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë e bën DKMSH-ja.

13.2. Qytetari, i sistemuar në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë (në vazhdim: pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë), pajiset me kartelë identifikimi të pjesëtarit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

13.3. Përmbajtja, forma dhe lëshuarja e kartelës së identifikimi të pjesëtarit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë do të rregullohet me Udhëzim Administrativ që do të nxirret nga Ministria e Punëve të Brendshme (ne tekstin e mëtejme MPB).

Neni 14

14.1. Qytetarët, që vullnetarisht dhe të pa thirrur i kryejnë detyrat e mbrojtjes, të shpëtimit dhe të ndihmës, sistemohen në njësi, shërbime dhe në struktura të tjera operative të shoqatave dhe të organizatave të tjera joqeveritare.

14.2. Njësitë, shërbimet dhe strukturat e tjera operative nga alineja 1 e këtij neni, në gjendje emergjente realizojnë, bashkë me forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, detyrat e mbrojtjes, të shpëtimit dhe të ndihmës.

Neni 15

Pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, duhet të aftësohet për kryerjen e detyrave, në përputhje me planprogramin e përpiluar nga DME-ja.

Neni 16

16.1. Pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë ftohet:

- i. në rivistë për sistemim,
- ii. në aftësimet themelore dhe plotësuese,
- iii. në ushtrime dhe forma të tjera të aftësimit praktik,
- iv. në kryerjen e detyrave të mbrojtjes, të shpëtimit dhe të ndihmës, si dhe në evitimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.
- v. në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, mund të thirret në shërbim për mbrojtje dhe shpëtim deri në përfundimin e gjendjes së krijuar nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

16.2. Pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, mund të kryejë shërbim në njësi dhe në shërbime të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, shërbime publike, si dhe në ndërmarrje, në institucione dhe në organizata që kryejnë aktivitete të rëndësishme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Neni 17

17.1. Qytetarët i zbatojnë obligimet materiale, duke iu dhënë në përdorim forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, automjetet, makinat dhe mjetet e tjera materiale, objektet, pajisjet, burimet energjetike, të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

17.2. Obligim material, është edhe vendosja e mjeteve dhe pajisjeve për vështrim, lajmërim dhe alarmim në ndërtesat afariste dhe në ndërtesa të tjera.

17.3. Qytetarët, të cilët kanë obligime materiale, duke u mbështetur në paragrafin 2 të këtij neni, nuk mund të pengojnë vendosjen e mjeteve dhe të pajisjeve ose t'i mënjanojnë ato.

17.4. Obligimi material mund t'u ngarkohet edhe personave juridikë, përveç për mjetet e destinuar për mjete mbrojtëse ose për përkujdesje shëndetësore, respektivisht për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në përputhje me këtë ligj.

Neni 18

18.1. Qytetari i cili është i sistemuar për të marrë pjesë në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë ose që ka obligime materiale, duhet të paraqitet në vendin dhe në kohën e caktuar, gjegjësisht duhet t'i dorëzojë mjetet materiale, në bazë të thirrjes së organit kompetent.

18.2. Nëse pjesëtari nuk i përgjigjet thirrjes apo nuk e arsyeton mosardhjen, DKMSH-ja lëshon urdhrin për sjellje të detyruar të pjesëtarit.

Neni 19

19.1. Pjesëtarit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, gjatë kryerjes së detyrave në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, gjatë aftësimit dhe realizimit të obligimeve materiale, në bazë të thirrjes së organit kompetent, i takon kompensimi, gjegjësisht fitimi i humbur për kohën e mungesës në punë, për shkak të kryerjes së detyrave të caktuara, në vlerë dhe në kushte si i përcakton Qeveria e Kosovës me akt të veçantë juridik.

19.2. Kompensimin nga paragrafi 1 i këtij neni e bën punëdhënësi në ngarkesë të subjektit, varësisht nga ajo se ku është i sistemuar qytetari në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë. Nëse qytetari është i sistemuar në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë pranë punëdhënësit, kompensimin e shpenzimeve për pagë e bën punëdhënësi.

19.3. Nëse kryerja e detyrave ose obligimeve në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë zgjat më shumë se 4 orë, pjesëtari ka të drejtë në ushqim pa pagesë, në ngarkesë të subjektit që e ka ftuar.

19.4. Punëdhënësi i pjesëtarit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, gjegjësisht qytetari, i cili në përputhje me këtë ligj merr pjesë gjatë realizimit të detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, nuk mund ta largojë nga puna ose t'ia ndërrojë vendin e punës.

Neni 20

20.1. Lëndimi ose sëmundja, e cila shfaqet gjatë kryerjes së detyrave, aftësimit dhe obligimeve materiale në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, trajtohet lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe pjesëtari gëzon të drejtat sipas dispozitave ligjore në fuqi.

20.2. Si lëndim nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet edhe lëndimi të cilin qytetari e ka marrë në rrugë nga shtëpia ose nga vendi i punës, deri në vendin e paraqitjes ose gjatë kthimit.

20.3. Vendin dhe kohën e lëndimit e përcakton organi, që e ka thirrur qytetarin, ose zyrtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

20.4. Familja e ngushtë e pjesëtarit, që ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, apo obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, ka të drejtë për pension dhe të drejtën e shpenzimeve, transportit dhe varrimit, në përputhje me rregullat për sigurim pensional, invalidor dhe sigurimin shëndetësor.

20.5. Shpenzimet e sigurimit shëndetësor, invalidor dhe pensional, i mbulon Qeveria, nëse qytetari nuk është i siguruar në ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 21

21.1. Qytetari që gjatë realizimit të detyrave ose të obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë lëndohet pa faj të vet, ashtu që organizmi i tij ka invaliditet së paku 20%, sipas rregullave për invalidë, ka të drejtë për ndihmë të njëhershme me para.

21.2. Për ndihmë të njëhershme me para, nga alineja 1 e këtij neni, qytetari ka të drejtë edhe në rastet kur organizmi i tij pëson invaliditet, së paku 20% nga sëmundja që është shkaktuar drejtpërsëdrejti nga kryerja e detyrave ose obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

21.3. Për ndihmë të njëhershme me para, nga alineja 1 e këtij neni, kanë të drejtë edhe anëtarët e familjes së ngushtë të pjesëtarit, që e ka humbur jetën gjatë kryerjes së detyrës, realizimit të obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

21.4. Vlera e ndihmës nga alinetë 1, 2, 3 të këtij neni përcaktohet nga Qeveria me Udhëzim Administrativ dhe nuk mund të jetë më e ulët se 12 paga mujore.

Neni 22

22.1. Pjesëtarit, i cili ka pësuar dëme gjatë kryerjes së detyrave dhe të obligimeve të tjera në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, ka të drejtë kompensimi sipas këtij ligji.

22.2. Qytetarët dhe personat juridikë, që janë të ngarkuar me obligime materiale, kanë të drejtë në kompensimin për përdorimin e mjeteve që i kanë dhënë për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe në kompensim dëmi, nëse ato janë dëmtuar ose shkatërruar.

22.3. Qeveria me akt të veçantë përcakton llojin e mjeteve materiale, që DKMSH-ja i përcakton si obligim material, si dhe vlerën e kompensimit për përdorim, pastaj mënyrën e përcaktimit dhe të pagesës së dëmit.

Neni 23

23.1. Komuna është përgjegjëse për kompensimin e dëmeve të shkaktuara personave, me qëllim apo për shkak të pakujdesisë, gjatë realizimit të aktiviteteve të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, si dhe për aftësimin dhe realizimin e aktiviteteve të tjera, të cilat janë në ndërlidhje me mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

23.2. Qytetari, i cili gjatë realizimit të detyrave e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia, nga paragrafi 1 i këtij neni, përgjigjet sipas ligjit.

Neni 24

MPB me udhëzim administrativ përcakton kriteret lidhur me detyrat dhe të drejtat e organeve përkatëse në grumbullimin, përpunimin, përdorimin dhe ruajtjen e të dhënave personale për pjesëtarët e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

IV- KOMPETENCAT

Neni 25

Kompetencat e Qeverisë në lëmin e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë janë:

- i. organizimi i sistemit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës,
- ii. miratimi i projekteve zhvillimore dhe i aktiviteteve hulumtuese për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. udhëheqja e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, që i godasin dy e më shumë komuna,
- iv. organizimi dhe realizimi i vështirimit, lajmërimit dhe alarmimit në nivel qendror dhe komunal si dhe përcaktimi i sistemit unik për alarmim (112),
- v. organizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- vi. vendos për angazhimin e të gjitha potencialeve njerëzore dhe materiale në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- vii. Qeveria, në rast të fatkeqësive të mëdha natyrore dhe fatkeqësive të tjera, vendos për kërkimin dhe marrjen e ndihmës nga shtetet e tjera.
- viii. themelimin e komitetit ndërministror për mbrojtje dhe shpëtim dhe
- ix. Qeveria themelon Fondin për intervenime në rastet emergjente

Neni 26

Komiteti Ndërministror për Mbrojtje dhe Shpëtim

26.1. Qeveria themelon Komitetin Ndërministror për Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe përcakton përbërjen e këtij komiteti (në tekstin e mëtejme: KNMSH).

26.2. KNMSH-ja qëndron i mbledhur deri në eliminimin e shkaqeve që kanë sjellë deri te emergjenca.

26.3. KNMSH-ja mund të thërrasë specialistë për këshillime në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Neni 27

Detyrat e Komitetit Ndërministror për Mbrojtje dhe Shpëtim

KNMSH –ja kryen këto detyra:

- i. në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera cakton drejtuesin e operacionit për menaxhimin e tyre (komandantin e incidentit),
- ii. bashkërendon veprimet e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. bashkërendon menaxhimin e rezervave shtetërore, si dhe përcakton mënyrën e përdorimit të tyre,
- iv. përcakton mënyrat dhe procedurat për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në rast emergjence,
- v. shqyrton dhe vendos paraprakisht për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,

- vi. vlerëson rindërtimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, me qëllim të mbrojtjes dhe shpëtimit të jetës dhe të shëndetit të njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, si dhe për të parandaluar dëmet e mundshme në të ardhmen dhe në sigurimin e kushteve bazë të jetesës,
- vii. kryen detyra të tjera, që burojnë nga ky ligj dhe detyra të veçanta, të caktuara nga qeveria për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Neni 28

Ministria e Punëve të Brendshme

28.1. Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore nga fatkeqësitë e tjera dhe kryen këto detyra:

- i. zbaton së bashku me institucionet e tjera politikën e Qeverisë në fushën e planifikimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera,
- ii. bashkërendon veprimet e të gjitha palëve në planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, për përmbushjen e detyrave që u përkasin atyre si dhe bashkërendon punët me organet e qeverisjes vendore për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera,
- iii. menaxhon sistemin e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- iv. zhvillon strategjitë e programeve të planifikimit dhe përballimit të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, dhe i paraqet ato për miratim në Qeveri,
- v. përpunon zbatimin e programeve të arsimimit dhe të trajnimit në fushën e mbrojtjes kundër fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- vi. në bashkëpunim me ministritë, institucionet dhe entet e ndryshme të vendit bën vlerësimin e rreziqeve mbi të cilat bazohet hartimi i planit të përgjithshëm për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera në Kosovë dhe e paraqet atë për miratim në Qeveri,
- vii. merr masa për sensibilizimin e opinionit publik dhe për ndërgjegjësimin e tij rreth fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera dhe planifikon fonde për hulumtime dhe studime nga institucionet publike për përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera,
- viii. lidh marrëveshje me shoqata dhe organizata që ofrojnë asistencën e tyre në realizimin e detyrave në planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera,
- ix. raporton sipas nevojës në çdo gjashtë muaj para Qeverisë për gjendjen e përgjithshme të planifikimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera,
- x. i siguron KNMSH-së të gjitha të dhënat e nevojshme për situatat e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera dhe për rreziqet që paraqesin ato,
- xi. ndjek punën për krijimin dhe përdorimin e rezervave shtetërore të vëna në dispozicion nga strukturat e rezervave të Kosovës, për situatat e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera,

- xii. organizon, zbaton dhe monitoron sistemin e të dhënave në nivel të Kosovës për situatat e fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera,
- xiii. bashkërendon punën për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera, në përputhje me aktet nënligjore përkatëse,
- xiv. kryen detyra të tjera që burojnë nga ky ligj, nga ligje të tjera dhe nga akte tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

28.2. Për kryerjen e detyrave të parapara për MPB-në, përgjegjës është Departamenti i Menaxhimit të Emergjencave-DME.

Neni 29 Ministritë

29.1. Çdo ministri është përgjegjëse për organizimin e planifikimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në veprimtarinë që ka në përgjegjësi.

29.2. Ministritë kryejnë këto detyra:

- i. hartojnë planet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas llojit të veprimtarisë dhe të përgjegjësisë së tyre dhe i paraqesin këto në MPB për bashkërendim,
- ii. zbatojnë planet dhe përcaktojnë masat për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera dhe të pasojave nga fatkeqësi të tilla në fushën e përgjegjësisë së tyre,
- iii. organizojnë trajnimin dhe arsimimin në fushën e veprimtarisë së tyre, në bashkërendim dhe këshillim me DME-në,
- iv. analizojnë gjendjen e planifikimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera në fushën e përgjegjësisë së tyre dhe njoftojnë DME-në.

Neni 30 Entet publike

30.1. Entet publike, kur u kërkohet nga DME-ja, kryejnë studime të cilat përfshijnë parashikimin, parandalimin dhe shmangien e pasojave të fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera dhe ia paraqesin këto studime DME-së.

30.2. Entet publike paraqesin te DME-ja edhe rezultatet e studimeve, që mund të jenë me interes për planifikimin dhe përballimin e fatkeqësive natyrore ose të fatkeqësive të tjera.

30.3. Mënyra e planifikimit dhe e përballimit të kostos përkatëse përcaktohet me vendim të Qeverisë.

Neni 31 Kompetencat e komunës

31.1. Kompetencat e komunës në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera janë:

- i. vështrimi, lajmërimi dhe alarmimi i popullsisë për kërcënim rreziku,
- ii. organizimi dhe mirëmbajtja e mjeteve për alarmim, në përputhje me sistemin unik të alarmimit,
- iii. organizimi-funksionimi i ndërlidhjeve për nevoja të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, në përputhje me sistemin unik të ndërlidhjes,
- iv. planifikimi dhe realizimi i masave për mbrojtje dhe shpëtim,
- v. vlerësimi i rrezikut dhe hartimi i planeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- vi. themelimi i komitetit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, organizimi i komiteteve, njësive dhe i shërbimeve të forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe i forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- vii. sigurimi i mjeteve urgjente për strehim të përkohshëm në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- viii. realizimi i programeve të aftësimin,
- ix. harmonizimi i planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë me komunat fqinje,
- x. organizimi, zhvillimi dhe udhëheqja e mbrojtjes personale dhe reciproke,

31.2. Komunitet, gjatë realizimit të detyrave të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera bashkëpunojnë ndërmjet vetes dhe mund t'i bashkojnë mjetet dhe shërbimet për realizimin e çështjeve të përbashkëta në mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 32

32.1. Institucionet dhe ndërmarrjet e tjera duhet të sigurojnë kushte dhe mundësi për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke si dhe realizimin e masave mbrojtëse të përcaktuara me këtë ligj.

32.2. Institucionet dhe ndërmarrjet e tjera që në procesin e punës përdorin, prodhojnë, transportojnë dhe deponojnë materie të rrezikshme, naftë dhe derivate të saj si dhe gazra energjetike dhe realizojnë veprimtarinë me mjete të rrezikshme, duhet ta vlerësojnë rrezikshmërinë dhe të hartojnë planin për mbrojtje dhe shpëtim në pajtim me dispozitat ligjore.

32.3. Institucionet dhe ndërmarrjet e tjera, nga paragrafi 2 i këtij neni, me shpenzime të veta duhet të vendosin dhe të mirëmbajnë pajisjet për ndërhyrje, të organizojnë forcat e nevojshme për shpëtim dhe ndihmë, të sigurojnë lajmërimin dhe alarmimin e punëtorëve

dhe të popullatës për rrezik, duke marrë parasysh madhësinë dhe shkallën e rrezikut, të cilën e shkakton veprimtaria e tyre.

32.4. Qeveria, me akt të veçantë, përcakton klasifikimin, emërtimin dhe sasi të materieve të rrezikshme, si dhe veprimtaritë dhe mjetet, nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 33

33.1. Pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave të banimit janë përgjegjës për ndërmarrjen e masave mbrojtëse që janë të përcaktuara dhe për sigurimin e mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

33.2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore janë përgjegjës për ndërmarrjen e masave të parapara mbrojtëse. Për këtë mund të kërkojnë ndihmë nga institucionet për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

33.3. Pronarët dhe shfrytëzuesit nga paragrafi 1 i këtij neni duhet që përgjegjësve kompetentë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera t'u japin në disponim të dhënat për ndërtesat dhe shfrytëzuesit e banesave.

V. PROGRAMI DHE PLANIFIKIMI

Neni 34

34.1. Projekti hulumtues dhe zhvillimor për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera është pjesë përbërëse e programeve qeveritare për hulumtim.

34.2. DME-ja merr pjesë gjatë vendosjes për projektet hulumtuese dhe zhvillimore në programin qeveritar për hulumtime, në mënyrë që të mund të propozojë projekte hulumtuese dhe zhvillimore në lëmin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

34.3. DME-ja, pas harmonizimit paraprak me ministritë gjegjëse për aktivitete hulumtuese, mund të financojë projektet hulumtuese dhe zhvillimore të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera në mënyrë vetjake.

Neni 35

35.1. Me programin qeveritar për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera përcaktohet qëllimi, politika dhe strategjia e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, për së paku 5 vjet.

35.2. Programi qeveritar përmban:

- i. përcaktimin dhe vlerësimin e rrezikshmërisë,
- ii. situatën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. përcaktimin e shkallës së mbrojtjes nga fatkeqësitë e veçanta natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iv. qëllimet themelore, detyrat e mbrojtjes dhe mënyra e realizimit të tyre,
- v. pasqyrën e masave parandaluese,
- vi. kahet e politikave shkencore, hulumtuese dhe zhvillimore,
- vii. drejtimit për organizimin e forcave dhe mjeteve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- viii. drejtimit për përpunimin e programeve arsimore, dhe
- ix. analizën dhe parallogaritë e shpenzimeve.

Neni 36

Detyrat nga programi qeveritar detajizohen në planin vjetor të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 37

Të gjitha planet në nivelet komunale për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, nuk mund të jenë në kundërshtim me planet qeveritare.

Neni 38

38.1. Planifikimi i mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe situata emergjente, duhet të bazohen në vlerësimin e rrezikshmërisë.

38.2. Vlerësimin e rrezikshmërisë në nivel të vendit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe gjendjen emergjente e bën DME-ja.

38.3. Vlerësimin e rrezikshmërisë për territorin e komunës e bën DKMSH-ja.

38.4. Qeveria përcakton metodologjinë për vlerësimin e rrezikshmërisë.

38.5. MPB-ja nxjerr udhëzim administrativ për përgatitjen e planit të përgjithshëm për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 39

Plani për mbrojtje dhe shpëtim duhet të plotësohet në rast të ndryshimit të shkallës së rrezikut, ose ndryshimit në forcat dhe mjetet ekzistuese për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, së paku një herë në vit.

VI. SISTEMI UNIK I ALARMIMIT DHE KOORDINIMIT EMERGJENT

Neni 40

40.1. Me Sistem Unik të Alarmimit dhe Koordinimit Emergjent (në tekstin e mëtejme: SUAKE) sigurohet paralajmërimi dhe informimi efikas dhe me kohë i publikut lidhur me fatkeqësitë natyrore dhe me fatkeqësitë e tjera.

40.2. SUAKE, siguron informata të sakta dhe me kohë të gjitha shërbimet emergjente të rëndësishme (TMK, SHPK, qendrat emergjente mjekësore spitalore dhe paraspitalore dhe shërbimet komunale, shërbimin komunal zjarrfikës dhe në qendrat emergjente mjekësore të komunave), sikurse edhe me shoqatat humanitare vendore dhe ndërkombëtare, agjenci dhe shoqata të specializuara në fushën e emergjencave.

40.3. SUAKE ka numrin identifikues 112, dhe është unik për tërë territorin e Kosovës.

40.4. SUAKE është i organizuar në nivel qendror dhe komunal.

40.5. SUAKE siguron komunikim dhe koordinim në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, me shtetet fqinje, rajonale dhe më gjerë.

40.6. Organizimi funksional dhe shtrirja e SUAKE-ës do të rregullohet me udhëzim administrativ të miratuar nga Qeveria.

VII. MASAT MBROJTËSE

Neni 41

Masat mbrojtëse janë:

- i. masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike,
- ii. evakuimi,
- iii. pranimi dhe furnizimi i qytetarëve të rrezikuar,
- iv. mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike,
- v. strehimi,
- vi. mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës.

Neni 42

42.1. Masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike, ndërmerren gjatë planifikimit dhe rregullimit të hapësirës dhe vendbanimeve, gjatë ndërtimit të objekteve me qëllim që të pengohet, respektivisht të zvogëlohet ndikimi negativ i fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, si dhe të mundësohen mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma.

42.2. Projektet për ndërtimin e objekteve, të destinuara për shfrytëzim kolektiv, furnizimin e qytetarëve, të transportit publik, si dhe deponimin, prodhimin, përdorimin e materieve të rrezikshme, të naftës dhe të derivateve të saj, si dhe të gazrave energjetike, duhet të përmbajnë elaborate të sigurimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

42.3. Qeveria, me udhëzim administrativ, përcakton llojin e objekteve nga alineja 2 e këtij neni, si dhe masat hapësinore, urbanistike, ndërtimore dhe masat e tjera teknike të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 43

43.1. Evakuimi i banorëve të rrezikuar bëhet nëse me masa të tjera nuk mund të garantohet siguria e tyre.

43.2. Vendimin për evakuim mund ta marrin Qeveria, kryetari i komunës ose komandanti kompetent i forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

43.3. Nga zonat ku është paraparë evakuimi, qytetarët duhet të kalojnë në vendin, kohën dhe mënyrën e përcaktuar sipas planeve të mbrojtjes dhe shpëtimit, gjegjësisht sipas vendimit të organit kompetent.

43.4. Zhvendosja e qytetarëve në komunën tjetër nuk mund të ndikojë në ndryshimin e statusit juridik të tyre.

43.5. Komuna, në territorin e së cilës janë evakuuar qytetarët, i mbulon shpenzimet e vendosjes dhe të furnizimit, si dhe arsimimin dhe përkujdesjen shëndetësore.

43.6. Shpenzimet, nga alineja 5 e këtij neni, komunës ia kompenson Qeveria, gjegjësisht komuna nga janë të evakuuarit.

Neni 44

44.1. Në pajtim me këtë ligj, Qeveria dhe komunat duhet t'u sigurojnë strehimin dhe furnizimin e domosdoshëm qytetarëve, të cilët për shkak të fatkeqësive natyrore apo fatkeqësive të tjera kanë mbetur pa strehim, si dhe mjetet për mbijetesë.

44.2. Kryetari i komunës, në raste të veçanta, vendos që pronarët ose shfrytëzuesit e ndërtesave banesore përkohësisht t'i pranojnë për banim të evakuarit dhe personat e rrezikuar, nga alineja 1 e këtij neni, nëse vendosja e tyre nuk mund të zgjidhet në mënyrë tjetër.

Neni 45

45.1. Mbrojtja radiologjike, kimike dhe biologjike, përbën masat dhe mjetet për mbrojtje të drejtpërdrejtë nga ndikimi i materieve radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe nga pasojat e fatkeqësive me materie të rrezikshme.

45.2. Pronarët dhe shfrytëzuesit e objekteve dhe të pajisjeve të destinuara për furnizim publik, transport dhe deponim të gjërave ushqimore, medikamenteve dhe ushqimit për shtazë, si dhe shërbimet publike, shëndetësore dhe ruajtje dhe arsimim të fëmijëve, duhet t'i sigurojnë mjetet mbrojtëse dhe t'i ndërmarrin masat e parapara për mbrojtje kimike, biologjike dhe radiologjike.

45.3. Qeveria, me udhëzim administrativ, e rregullon organizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike, si dhe përcakton mjete për mbrojtje dhe masat, nga alineja 2 e këtij neni.

Neni 46

46.1. Për strehimin e njerëzve në vende publike përdoren strehimoret, gjegjësisht për këtë qëllim adaptohen objektet përkatëse.

46.2. Për strehimore publike kujdeset komuna.

Neni 47

47.1. Strehimoret, për strehim themelor, duhet të ofrojnë mbrojtjen nga shtypja, rrënimet, të reshurat radioaktive, zjarret dhe nga ndikimet e materieve kimike.

47.2. Strehimoret, për mbrojtje plotësuese, duhet të ofrojnë mbrojtjen nga rrënimet.

Neni 48

48.1. Komuna dhe shfrytëzuesi duhet t'i mirëmbajnë strehimoret në atë gjendje, që t'i plotësojnë kërkesat për përdorim.

48.2. Ndryshimet në strehimore nuk janë të lejuara, nëse ato zvogëlojnë funksionin e mbrojtjes.

Neni 49

49.1. Investitorët duhet t'i ndërtojnë strehimoret me mjete vetjake.

49.2. Investitor i strehimoreve publike është komuna.

49.3. Për përshpejtimin dhe ndërtimin e strehimoreve, Qeveria mund të marrë garancion apo lejon subvencionet.

49.4. Komuna përcakton lokacionin dhe objektet ku duhet të ndërtohen strehimoret, si dhe kushtet për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

49.5. Qeveria vendos për kërkesat, për marrjen e garancive dhe dhënien e subvencioneve.

49.6. Qeveria, me udhëzim administrativ, i rregullon normat teknike për strehimore dhe adaptimin e objekteve për strehim.

Neni 50

50.1. Mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës nënkupton përgatitjet për realizimin e masave për zvogëlimin e rrezikut, si parandalimin dhe zvogëlimin e ndikimit negativ të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera në trashëgiminë kulturore dhe të natyrës.

50.2. Përgatitjet dhe masat, nga alineja 1 e këtij neni, i realizojnë pronarët dhe shfrytëzuesit e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës, komunat dhe Qeveria.

50.3. Gjatë realizimit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore dhe të natyrës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas nevojës, marrin pjesë edhe njësitë dhe shërbimet gjegjëse të mbrojtjes dhe shpëtimit, njësitë e zjarrfikësve, si dhe forcat e tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

50.4. Qeveria e Kosovës, me udhëzim administrativ, rregullon mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera konform legjislacionit në fuqi lidhur me këtë çështje.

VIII MBROJTJA PERSONALE DHE RECIPROKE

Neni 51

51.1. Mbrojtja personale dhe reciproke përfshin masat që duhet të ndërmarrin qytetarët për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera për shëndetin e tyre, si dhe sigurinë e pasurisë së tyre konform planit për mbrojtje dhe shpëtim.

51.2. Qeveria parasheh mjetet dhe pajisjet për mbrojtje personale dhe reciproke, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, të cilat duhet t'i kenë në dispozicion qytetarët, pronarët dhe shfrytëzuesit e ndërtesave, ndërmarrjet ekonomike, institucionet dhe organizatat e tjera, si dhe organet qeveritare.

IX. FORCAT PËR MBROJTJE DHE SHPËTIM NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE NGA FATEKEQËSITË E TJERA

Neni 52

Mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, përfshin:

- i. ndihmën e parë mjekësore,
- ii. ndihmën e parë veterinare,

- iii. shuarjen e zjarreve dhe shpëtimin nga zjarret,
- iv. shpëtimin nga rrënojat, ortekët, rrëshqitjet (dheu, bora),
- v. shpëtimin nga vërshimet, katastrofat e tjera meteorologjike, fatkeqësitë ekologjike dhe nga fatkeqësitë e tjera nga lumenjtë dhe liqenet,
- vi. shpëtimin në bjeshkë,
- vii. shpëtimin në ujëra,
- viii. shpëtimin në fatkeqësitë e mëdha në trafik,
- ix. shpëtimin në fatkeqësitë në miniera,
- x. sigurimin nga mjetet shpërthyes të paeksplojuara,
- xi. realizimin e mbrojtjes radiologjike, kimike dhe biologjike në rast të përdorimit të materieve të rrezikshme, dhe
- xii. sigurimin e kushteve elementare për jetë.

Neni 53

Forcat për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera janë:

- i. njësitet e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- ii. njësitë, shërbimet dhe strukturat operative të shoqatave dhe të organizatave joqeveritare,
- iii. ndërmarrjet dhe institucionet,
- iv. Trupat e Mbrojtjes të Kosovës,
- v. Shërbimi Policor i Kosovës dhe policia e UNMIK-ut, dhe
- vi. KFOR-i.

Neni 54

54.1. Njësitë, shërbimet dhe strukturat e tjera operative të shoqatave dhe të organizatave të tjera joqeveritare, realizojnë detyrat e mbrojtjes, të shpëtimit dhe të ndihmës, gjegjësisht shërbimin publik, në bazë të vendimit të organit kompetent komunal dhe qeveritar, nëse i përmbush kushtet e parapara.

54.2. Organi kompetent vendos për:

- i. strukturën, vëllimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave, gjegjësisht të shërbimeve publike,
- ii. fillimin e realizimit të detyrave në raste emergjente,
- iii. mjetet financiare që i siguron komuna, gjegjësisht Qeveria për kryerjen e detyrave në raste emergjente,
- iv. mjetet financiare për pagesën e kompensimeve, në përputhje me këtë ligj për qytetarët që pësojnë gjatë intervenimit dhe sëmundjes profesionale, dhe
- v. mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave në raste emergjente.

Neni 55

Shërbimet publike për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë janë:

- i. shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi, të cilin e kryejnë njësitet e zjarrfikësve në përputhje me ligjin për mbrojtje nga zjarri,
- ii. shërbimi i shpëtimit bjeshkatar, të cilin e realizojnë shoqatat bjeshkatore të Kosovës në përputhje me vendimet e organeve kompetente qeveritare,
- iii. shërbimi për mbrojtje dhe shpëtim në rast të fatkeqësive ekologjike dhe fatkeqësive të tjera,

- iv. shërbimi emergjent mjekësor, dhe
- v. shërbimet e tjera profesionale.

Neni 56

56.1. Për realizimin e detyrave operative nga fusha e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, organi kompetent i Qeverisë ose i komunës mund të përcaktojë ndërmarrjet ose institucionet që kanë në dispozicion mjete dhe kuadro përkatëse.

56.2. Ndërmarrjet dhe institucionet, nga alineja 1 e këtij neni, përcaktojnë organizimin për realizimin e detyrave, kujdesen për aftësim profesional të punëtorëve të tyre, si dhe realizojnë aktivitete dhe përgatitje të tjera për veprim në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

56.3. DKMSH-ja, organi qeveritar apo organi kompetent i ndërmarrjeve dhe institucioneve të tjera, për personat të cilët i cakton për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, siguron kompensimin e shpenzimeve reale për pjesëmarrje gjatë kryerjes së detyrave, si dhe për realizimin e përgatitjeve, të cilat i tejkalojnë aktivitetet e tyre të rëndomta.

Neni 57

57.1. Për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, organizohen njësitë dhe shërbimet e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si vijon:

- i. njësitë për ndihmë të parë mjekësore,
- ii. njësitë për ndihmë të parë veterinare,
- iii. njësitë teknike shpëtimtare,
- iv. njësitë dhe shërbimet për mbrojtje radiologjike, kimike dhe biologjike,
- v. njësitë për logjistikë,
- vi. njësitë për evakuim dhe strehim,
- vii. njësitë për asanimin e terrenit,
- viii. njësitë për mbrojtjen e bimëve,
- ix. njësitë për deaktivizimin e mjeteve të paeksplojuara, dhe
- x. njësitë për fikje të zjarrit.

57.2. Qeveria, komuna, ndërmarrjet dhe institucionet e tjera, organizojnë njësitë dhe shërbimet nga alineja 1 e këtij neni, në përputhje me kriteret për organizimin, kompletimin dhe përgatitjen e forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, të cilat i përcakton Qeveria.

Neni 58

58.1. Mbrojtja nga mjetet e paeksplojuara përmban - zbulimin, sigurimin, largimin, transportin dhe shkatërrimin e tyre.

58.2. Pjesëtarët e njësive për mbrojtje nga mjetet e paeksplojuara, detyrat, nga alineja 1 e këtij neni i realizojnë nëse e kanë autorizimin e Qeverisë.

58.3. Qeveria, me akt të veçantë juridik, rregullon mbrojtjen nga mjetet e paeksplojuara.

Neni 59

59.1. Për angazhimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe të forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë vendos Qeveria.

59.2. Për aktivizimin e forcave për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe të forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, në nivel lokal vendos komiteti komunal për mbrojtje dhe shpëtim, kurse në nivel qendror Komiteti ndërministror për mbrojtje dhe shpëtim.

Neni 60

Rendin dhe sigurinë publike në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në rajonin e goditur e siguron Shërbimi Policor i Kosovës.

X. UDHËHEQJA DHE ADMINISTRIMI

Neni 61

61.1. Udhëheqja e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë organizohet dhe realizohet si sistem unik.

61.2. Udhëheqjen nga paragrafi 1 e realizojnë komitetet përkatëse, si dhe udhëheqësit e njësive për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

61.3. Udhëheqja mbështetet në kryerjen obliguese të detyrave dhe vendimeve të organeve kompetente për udhëheqjen e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Neni 62

Njësitë, shërbimet dhe përbërjet e tjera të shoqatave dhe të organizatave joqeveritare, të cilat marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, i udhëheqin udhëheqësit e tyre në përputhje me rregullat e parapara me këtë ligj.

Neni 63

Gjatë mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, nëse marrin pjesë njësitë e TMK-së, komandimin me ato e udhëheqin eprorët e tyre, në pajtim me udhëzimet e komandantit të incidentit.

Neni 64

Detyrat e komandantit të incidentit janë:

- i. verifikon përgatitjen për intervenim të forcave dhe të mjeteve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- ii. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive,
- iii. kujdeset për veprimin dhe koordinimin e të gjitha forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- iv. ndalon hyrjen e personave të paautorizuar në vendin e fatkeqësive,
- v. urdhëron largimin e njerëzve, të shtazëve dhe pasurisë nga objektet dhe zonat e rrezikuara,
- vi. lejon përdorimin e mjeteve të ndërlihdjes, përkatësisht vendosjen e tyre;
- vii. urdhëron largimin e pengesave, të cilat e pengojnë intervenimin,

- viii. lejon përdorimin e mjeteve transportuese, të huazuara për transportin e të lënduarve, gjegjësisht të mjeteve të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- ix. urdhëron pjesëmarrjen obliguese të qytetarëve gjatë shpëtimit, sipas aftësive dhe mjeteve përkatëse për shpëtim,
- x. lejon përdorimin e sipërfaqeve tokësore të huazuara, të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- xi. urdhëron rrënimin e objektit, apo eliminimin e pengesave,
- xii. koordinon aktivitetet e agjencive të huaja, dhe
- xiii. informon si dhe autorizon dhënien e informacioneve për medie.

Neni 65

Nëse për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera nevojiten forca dhe mjete nga komuna fqinje, komandanti i incidentit i rekomandon komitetit të kërkojë ndihmë nga komuna tjetër.

Neni 66

66.1. Në realizimin e detyrave operative për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, për udhëheqje me forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, themelohen komitetet e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

66.2. Komitetet e forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë janë:

- i. Komiteti Ndërministror për Mbrojtje dhe Shpëtim i Kosovës;
- ii. komitetet komunale për mbrojtje dhe shpëtim,
- iii. komitetet e ndërmarrjeve dhe të institucioneve të tjera.

66.3. Komitetin e udhëheq kryetari i komitetit, e në raste të mungesës së tij, zëvendësi i tij.

66.4. Komiteti ka numër të caktuar të anëtarëve, të cilët emërohen nga profesione të ndryshme dhe nga përfaqësues të organeve, organizatave dhe shërbimeve, të cilat marrin pjesë në mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, në pajtim me planin e mbrojtjes dhe të shpëtimit.

Neni 67

67.1. Në forcat për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës përdoren këto shenja:

- i. shenjat e pjesëtarit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës,
- ii. shenjat e pozitës (gradat),
- iii. shenjat e specializimit të njësiveve dhe të shërbimeve.

67.2. Ndalohet reprodukimi, apo përdorimi i paautorizuar i shenjave dhe uniformës së forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës.

67.3. Qeveria, me udhëzim administrativ, vendos për shenjat, për llojin, formën dhe mbrojtjen e uniformës të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës.

Neni 68

68.1. Pjesëtari i forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës, gjatë kryerjes së detyrave, bart uniformën, shenjen përkatëse dhe kartelën e identifikimit.

68.2. Anëtarët e njësisve, shërbimeve dhe të përbërjeve të tjera operative të shoqërive dhe të organizatave të tjera joqeveritare, ndërmarrjet dhe institucionet e tjera, gjatë kryerjes së detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës, me rastin e fatkeqësive, përveç shenjave të veta, përdorin edhe shenjat e përkatësisë të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë të Kosovës.

Neni 69

69.1. Për rezultatet e dalluara në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, jepen mirënjohe dhe shpërblime për:

- i. kontribut në parandalimin e rreziqeve,
- ii. kontribute në realizimin e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës,
- iii. veprime të guximshme,
- iv. shpikje dhe inovacione,
- v. arritje në zhvillim dhe hulumtim,
- vi. arritje në arsimim dhe aftësim,
- vii. veprën jetësore në fushën e sigurimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

69.2. Mirënjohet dhe shpërblimet, nga alineja 1 e këtij neni, i parasheh Qeveria me udhëzim administrativ.

Neni 70

Në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, Kuvendi i Kosovës:

- i. përcakton kahet themelore për organizimin dhe realizimin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- ii. miraton planin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. mbikëqyr zbatimin e planit, si dhe realizimin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iv. vendos për sigurimin e mjeteve dhe nevojave të tjera për eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë e mëdha natyrore, dhe
- v. miraton planin e funksionimit dhe zhvillimit të forcave për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

Neni 71

Në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, Qeveria e Kosovës:

- i. drejton dhe harmonizon organizimin, zhvillimin, përgatitjet dhe realizimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera në Kosovë,
- ii. propozon planin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën, si dhe veprimet për eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë e mëdha natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,

- iv. administron ndihmën ndërkombëtare në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- v. emëron Komisionin për vlerësimin e dëmeve në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,
- vi. informon Kryetarin e Kosovës dhe Kuvendin e Kosovës për rastet e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, për pasojat që vijnë si dhe për masat e marra për shmangien e tyre.

Neni 72

72.1. Anëtarët e Komisionit për vlerësimin e dëmeve nga pika (v) e nenit 71 të këtij ligji emërohen nga radhët e ekspertëve dhe përfaqësuesve të administratës qendrore, komunale, ndërmarrjeve, institucioneve dhe kompanive të sigurimeve.

72.2. Të dëmtuarit mbledhin të dhënat për dëmet, të cilat iu kanë ndodhur nga fatkeqësia natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe ia paraqesin komisionit kompetent për vlerësimin e dëmeve.

72.3. Dëmet materiale dhe pasojat e tjera të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, komisionet i vlerësojnë në bazë të metodologjisë së përcaktuar nga Qeveria.

Neni 73

Kuvendi i Komunës nga lëmi i mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera:

- i. kujdeset për realizimin e përgatitjeve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- ii. kujdeset për ndërmarrjen e masave për pengimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën, si dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iv. emëron komandantin dhe themelon Komitetin për Mbrojtje dhe Shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,

Neni 74

74.1. Qeveria drejton dhe harmonizon aktivitetet e ministrive në fushën e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

74.2. Ministrinë janë përgjegjëse për realizimin e masave për parandalimin e fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, respektivisht pasojave të tyre në fushën e fushëveprimit të tyre.

74.3. Ministrinë janë përgjegjëse për gjendjen e përgatitjeve për realizimin e veprimeve nga kompetencat e tyre, në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

74.4. Në planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, përcaktohen detyrat e Qeverisë, të ministrive dhe të shërbimeve qeveritare për mbrojtje shpëtim dhe ndihmë.

Neni 75

DME-ja realizon, detyrat profesionale dhe administrative të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si vijon:

- i. harton propozimet e projekteve hulumtuese dhe zhvillimore të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- ii. harton propozimin e planit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. kujdeset për organizimin dhe funksionimin e sistemit të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit,
- iv. harton vlerësimin e rrezikut dhe bazat e tjera profesionale për planifikimin e mbrojtjes, shpëtimit dhe të ndihmës, si dhe harmonizon masat për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, në bashkëpunimin me ministrinë e tjera,
- v. përcjell dhe lajmëron rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe jep udhëzime për veprim në bashkëpunimin me ministrinë dhe shërbimet qeveritare,
- vi. organizon, kompletion dhe aftëson njësitë qendrore dhe shërbimet e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe forcat e tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- vii. siguron kushtet për punë të KNMSH-së nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe të Komisionit qendror për vlerësimin e dëmeve,
- viii. përcjell dhe bashkërendon organizimin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, dhe të forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- ix. përgatit programet, organizon dhe realizon arsimimin dhe aftësimin për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë, dhe
- x. krijon e mirëmban rezervat e mjeteve materiale qeveritare për raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

Neni 76

DKMSH-ja është përgjegjëse për realizimin e detyrave profesionale dhe administrative në lëmin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera në territorin e vet, si dhe:

- i. harton planin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në pajtim me udhëzimet administrative të organit kompetent qeveritar,
- ii. vlerëson rrezikshmërinë, duke u bazuar në të dhënat faktike për planifikim, ndërmerri masa parandaluese për pengimin, zvogëlimin dhe eliminimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- iii. propozon formimin e njësiteve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe kryen plotësimin e tyre me obligues dhe kompletion ato me mjete adekuate për veprim në raste të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera,

- iv. përgatit programet për aftësim, në pajtim me organin qeveritar,
- v. kujdeset për sigurimin dhe mirëmbajtjen e rezervave të mjeteve materiale për raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera,
- vi. organizon funksionimin e sistemit të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit,
- vii. kryen edhe punë të tjera nga lëmi i mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, në bashkëpunim me organet kompetente komunale dhe qeveritare.

Neni 77

77.1. Organi i administratës në ndërmarrjet dhe institucionet e tjera:

- i. kujdeset për realizimin e përgatitjeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- ii. udhëheq mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera.

77.2. Për udhëheqjen profesionale - operative të forcave për mbrojtje shpëtim dhe ndihmë, organi, nga alineja 1 e këtij neni, emëron komandantin dhe komitetin për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe miraton planet e mbrojtjes, shpëtimit dhe të ndihmës.

XI. INSPEKTORATI

Neni 78

78.1. Mbikëqyrjen e realizimit të dispozitave të këtij ligji dhe të dispozitave të tjera, me të cilat rregullohet mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, i bën Inspektorati i Kosovës për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera (në tekstin e mëtejshëm: Inspektorati).

78.2. Inspektorati funksionon si njësi në DME, dhe për funksionimin e tij, kompetencat dhe detyrat do të nxirret udhëzim administrativ nga Qeveria.

78.3. Inspektorët gjatë realizimit të inspektimit verifikojnë:

- i. ndërmarrjen e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e pasojave nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera,
- ii. gjendjen e planeve dhe përgatitjeve të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- iii. realizimin e detyrave të vështrimit, lajmërimit dhe alarmimit,
- iv. aftësimin, kompletimin dhe përgatitjen e njësive dhe të shërbimeve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe të forcave të tjera për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- v. realizimin e programit të aftësimit për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë,
- vi. kryerjen e punëve administrative dhe profesionale në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

78.4. Inspektorati për realizimin e inspektimit, nga paragrafi 2 i këtij neni, mund të përcaktojë verifikimin praktik.

78.5. Nga paragrafi 3 i këtij neni, në territorin e komunës, detyrat i kryejnë edhe inspektorët komunalë për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

Neni 79

79.1. Inspektorati, përveç kompetencave të përgjithshme për inspektim, ka edhe këto kompetenca dhe obligime:

- i. të urdhërojë, që deri në marrjen e vendimit të organit kompetent, të ndërpresë aktivitetin, gjegjësisht përdorimin e objektit, të aparateve, makinave, mjeteve transportuese, veprimeve teknologjike, përdorimin e materialeve apo mjeteve të tjera, nëse ekziston rreziku direkt për fatkeqësi,
- ii. të urdhëron me vendim, që në afat të caktuar kohor, ose në mënyrë të caktuar të eliminohen mangësitë e verifikuara apo mospërputhja me rregullat, planet dhe vendimet e organeve kompetente për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

79.2. Kundër vendimit me shkrim të Inspektoratit, nga alineja 1 e këtij neni, mund të ushtrohet ankesë organit kompetent, në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit, e cila nuk pengon ekzekutimin e saj.

XII. PUNA PROFESIONALE DHE SIGURIA NË PUNË

Neni 80

80.1. Për punëtorët për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, vlejnë rregullat e punës si për punëtorët e administratës civile, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe.

80.2. Punëtori, i cili në mënyrë profesionale e kryen detyrën në lëmin e mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, sipas vendimit të udhëheqësit, duhet t'i kryejë detyrat në kushte të posaçme.

80.3. Kushtet e posaçme të punës janë:

- i. puna të dielave dhe gjatë festave,
- ii. puna me orar të ndarë të punës,
- iii. puna më e gjatë se orari i rregullt i punës,
- iv. kujdestaria, si formë e rëndomtë në punë, gjegjësisht kujdestaria e cila përcaktohet në raste të veçanta,
- v. puna në terren dhe kohë të caktuar,
- vi. puna në mjedise të kontaminuara dhe puna në kushte të tjera, që paraqesin rrezik për shëndet dhe jetë,
- vii. gatishmëria e përhershme për punë në përputhje me nevojat zyrtare,
- viii. ndërprerja e pushimit sipas nevojave zyrtare.

80.4. Nëse punëtori gjatë kujdestarisë, apo gatishmërisë për punë, punon, koha e punës reale llogaritet si punë me orar të vazhduar.

80.5. Nëse punëtori tejkalon obligimet e orarit të punës mujore ose javore, ndryshimi llogaritet si punë jashtë orarit të plotë të punës.

80.6. Puna në kushte të posaçme, konsiderohet puna që paraqet rrezik nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera.

Neni 81

81.1. Gjatë kryerjes së punës në lëmin e mbrojtjes dhe të shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, zbatohen rregullat e përgjithshme për sigurimin e punëtorëve në punë.

81.2. Qeveria i përcakton masat dhe veprimet për garantimin e sigurisë dhe të shëndetit të punëtorëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, si dhe të pjesëtarëve të njëjsteve, shërbimeve dhe të përbërjeve të tjera operative të shoqatave dhe organizatave të tjera joqeveritare.

Neni 82

82.1. Të punësuarit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, gjatë grevës duhet të sigurojnë:

- i. aktivitetin e pandërprerë të sistemit të vështimit, lajmërimit dhe alarmimit, si dhe sistemin e ndërlikohjes,
- ii. kryerjen e pandërprerë të detyrave operative-profesionale për funksionimin e komiteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, gjegjësisht të organeve të tjera për udhëheqjen e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës.

82.2. Të punësuarit nga alineja 1 e këtij neni nuk kanë të drejtë greve gjatë fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera, apo nëse është paralajmëruar rreziku nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera.

82.3. Gjatë grevës nuk lejohet përdorimi i sinjaleve të alarmimit, si dhe i pajisjeve e mjeteve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë.

XIII. ARSIMIMI DHE AFTËSIMI

Neni 83

Për pjesëtarët për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, organizohet arsimimi themelor dhe i mesëm:

- i. në arsimimin themelor mësohen njohuritë themelore për rreziqet nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësi të tjera,
- ii. në arsimin e ulët dhe të mesëm mësohen njohuritë për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera në përputhje me programin arsimor gjegjës.

Neni 84

Aftësimi i pjesëtarëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, për kryerjen e detyrave nga ky lëmë përfshin aftësimin themelor dhe plotësues:

- i. aftësimi themelor i pjesëtarëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, mund të zgjatë më së shumti 15 ditë, ndërsa arsimi plotësues zgjat më së shumti 5 ditë në vit,
- ii. aftësimi themelor mund të zgjatë më tepër se sa që parashihet nga alineja 1 e këtij neni në bazë të vendimit të organit kompetent,

- iii. aftësimi plotësues i pjesëtarëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, sipas rregullave, organizohet në ditët e lira,
- iv. pjesëtarëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, u dorëzohet ftesa së paku 8 ditë para fillimit të aftësimit.

Neni 85

85.1. Pjesëtarit për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, i shtyhet aftësimi me kërkesë të tij nëse:

- i. për shkak të sëmundjes apo lëndimit, nuk mund të lajmërohet për aftësim, dhe
- ii. kujdeset për anëtarin e sëmurë të familjes.

85.2. Aftësimi mund të shtyhet edhe për shkak të nevojave zyrtare dhe punëve stinore bujqësore.

85.3. Kërkesa për shtyrje të aftësimit duhet të paraqitet në afat prej 8 ditësh nga marrja e ftesës.

Neni 86

86.1. Qeveria e Kosovës themelon Qendrën për aftësim dhe trajnim profesional (në vazhdim: Qendra).

86.2. Qendra, nga paragrafi 1 i këtij neni, realizon programe për aftësimin e pjesëtarëve për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, të anëtarëve të njëjësive dhe të strukturave të tjera operative, të shoqatave joqeveritare, të ndërmarrjeve ekonomike dhe të institucioneve.

86.3. Qeveria me udhëzim administrativ rregullon organizimin dhe funksionimin e Qendrës.

XIV- FINANCIMI

Neni 87

Forcat për mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, financohen nga:

- i. buxheti i konsoliduar Kosovës,
- ii. donacionet vullnetare,
- iii. ndihma ndërkombëtare.

Neni 88

88.1. Nga buxheti i Kosovës sigurohen mjetet për financim administrativ, profesional, mbikëqyrës dhe detyra të tjera të sigurisë nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, të cilat janë në kompetencë të Qeverisë.

88.2. Qeveria dhe komunat, në përputhje me kompetencat e veta, i sigurojnë mjetet financiare për mbulesën e shpenzimeve për kryerjen e detyrave të mbrojtjes, shpëtimit dhe të ndihmës për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njerëzve, shtazëve, pasurisë dhe mjedisit.

88.3. Ndërmarrjet dhe institucionet e tjera, që sipas këtij ligji duhet të organizojnë mbrojtje dhe shpëtim nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera dhe ndërmarrin edhe masa të tjera për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, garantojnë mjetet për paga të punëtorëve në kohën e aftësisë së tyre, si dhe mjete për përgatitjen dhe shpenzime të tjera të trajnimit.

Neni 89

89.1. Mjetet për ndihmë gjatë eliminimit të dëmeve dhe pasojave të tjera të fatkeqësive natyrore, sigurohen nga buxheti i Kosovës.

89.2. Propozimet për përdorimin e mjeteve, nga alineja 1 e këtij neni, i përgatit, në bazë të vlerësimit dhe propozimit, Komisioni qeveritar për vlerësimin e dëmeve, të cilin e emëron Qeveria. Për propozimet e Komisionit vendos Qeveria.

XV. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 90

90.1. Me gjobë, në vlerë së paku 1.000 euro gjer në 5.000 euro, për kundërvajtje dënohet personi juridik ose fizik, që bën kundërvajtje në lidhje me realizimin e veprimtarisë vetjake:

- i. nëse nuk e lajmëron menjëherë qendrën më të afërt për lajmërim, apo organin kompetent për rrezikun nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera (alineja 2 neni 9),
- ii. nëse nuk i kryen apo në ndonjë mënyrë tjetër i ikën kryerjes së obligimeve materiale (neni 17 dhe 18),
- iii. nëse në afat prej 15 ditësh nuk e lajmëron organin administrativ për ndryshimet e të dhënave,
- iv. nëse nuk siguron kushte apo mundësi për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke të punëtorëve, apo nuk i realizon masat e parapara mbrojtëse (alineja 1 e nenit 51),
- v. nëse në procesin e punës përdor, prodhon, transporton apo deponon materie të rrezikshme, si naftë, derivate të saj, gazra energjetike, nëse kryen aktivitete ose punon me mjete për punë që paraqesin rrezik për ndodhjen e fatkeqësive, apo nuk bën vlerësimin e rrezikut dhe planin e mbrojtjes e të shpëtimit (alineja 2 e nenit 42),
- vi. nëse duke marrë parasysh madhësinë dhe shkallën e rrezikut në shpenzime vetjake, nuk e bën dhe mirëmban pajisjen për intervenim, apo nëse nuk organizon forca të nevojshme për shpëtim dhe ndihmë, apo nuk e siguron lajmërimin dhe alarmimin e punëtorëve a të qytetarëve për rrezikun, apo nuk bashkë financon një pjesë me ndërmarrjet, institucionet e tjera, që dalin nga rrezikshmëria, që e shkaktojnë (neni 42),
- vii. nëse si pronar ose shfrytëzues i ndërtesave të banimit apo i ndërtesave të tjera nuk ndërmerr masa të parapara mbrojtëse, apo nuk siguron mjete të parapara mbrojtëse për shpëtim dhe ndihmë (alineja 2, neni 45), apo nëse nuk ndërmerr masa të parapara për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe të natyrës (alineja 2 neni 33),

- viii. nëse si pronar apo shfrytëzues i ndërtesave banesore, apo ndërtesave të tjera nuk mundëson veprimin e përgjegjësitet kompetent të mbrojtjes dhe shpëtimit, apo nuk i jep të dhënat për ndërtesën, ose përmbledhjen e të dhënave për banorë dhe shfrytëzues të tjerë të ndërtesës (alineja 3, neni 33),
- ix. nëse nuk i harton planet për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera,
- x. nëse si pronar apo shfrytëzues i objekteve, të aparateve të destinuara për furnizimin publik, prodhim, transport apo deponim të ushqimit, të medikamenteve, të ushqimit për shtazë, të shërbimeve publike shëndetësore, ruajtjes dhe arsimimit të fëmijëve, nuk siguron mjete mbrojtëse, apo nuk ndërmer masa të parapara mbrojtëse për mbrojtje radiologjike, biologjike dhe kimike (alineja 2, neni 45),
- xi. nëse si pronar apo shfrytëzues i strehimoreve nuk mirëmban strehimoret në atë gjendje, që i përmbush kushtet për përdorimin e tyre, apo në rast rreziku nuk ua mundëson përdorimin e strehimores atyre personave, për të cilët është e destinuar strehimorja (alineja 1, neni 48),
- xii. nëse nuk bën organizimin përkatës për kryerjen e detyrave, nuk kujdeset për aftësimin profesional të punëtorëve, ose nuk ndërmer përgatitje të tjera për veprim në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera (alineja, 2 neni 86),
- xiii. nëse reprodikon, apo në mënyrë të paligjshme i përdor shenjat dhe uniformën e forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, apo reprodikon dhe në trafik përdor automjetet, të cilat janë të ngjashme me automjetet dhe mjetet tjera transportuese të forcave për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, (alineja 2, neni 67),
- xiv. nëse silltet në kundërshtim me vendimet e inspektorit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera (alineja 1, neni 79).

90.2. Me gjobë, në vlerë prej 250 eurosh, për kundërvajtje dënohet personi përgjegjës i personit juridik, nëse vepron në kundërshtim nga pika (xiii) e këtij neni.

Neni 91

Me gjobë, në vlerë prej 800 - 1.500 euro, për kundërvajtje dënohet personi përgjegjës i organit qeveritar, apo i organit komunal:

- i. nëse organi kompetent qeveritar apo komunal nuk bën vlerësimin e rrezikut për lëmin e vet (pika (iv) e nenit 75, dhe pika (ii) e nenit 76),
- ii. nëse organi kompetent komunal nuk bën planin komunal për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera (pika (i) e nenit 76), dhe
- iii. nëse vepron sikurse në pikat vii, viii, ix, x, xi, xii të nenit 90 të këtij ligji.

Neni 92

Me gjobë, në vlerë prej 500 eurosh, për kundërvajtje dënohet individi:

- i. nëse nuk e kryen, apo i ikën pa arsye kryerjes së detyrave për pjesëmarrje në forcat e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, (neni 10),
- ii. nëse nuk i realizon obligimet materiale me dhënie në përdorim për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, automjetet, makinerinë, pajisjet dhe mjetet e tjera materiale, tokën, objektet, aparatet, burimet energjetike, të nevojshme për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në raste emergjente (pika 1, neni 17),
- iii. nëse pengon, apo i largon mjetet ose aparatet për vështrim, lajmërim dhe alarmimin nga ndërtesat afariste dhe nga ndërtesat e tjera (pika 2, neni 17),
- iv. nëse në bazë të thirrjes së organit kompetent, apo pa arsyetim nuk lajmërohet në vendin e përcaktuar ose nuk e dorëzon mjetin material (pika 2, neni 18),
- v. nëse si pronar apo shfrytëzues i shtëpisë së banimit, në bazë të urdhëresës së kryetarit nuk dëshiron t'i pranojë përkohësisht për strehim në banesë personat e evakuuar, apo të rrezikuar (pika 2, neni 44), dhe
- vi. nëse e kryen veprën nga pikat i, iii, vii, viii, xi dhe xiv të nenit 90 të këtij ligji.

XVI. DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 93

Organet e përcaktuara me këtë ligj janë të obliguara që t'i nxjerrin aktet nënligjore të parapara me këtë ligj, më së largu një vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 94

Ky ligj shfuqizon të gjitha dispozitat e Ligjit të aplikueshëm me të cilat është në papajtueshmëri.

Neni 95

Ky ligj hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Kuvendit të Kosovës dhe shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm.

Ligji Nr. 02/L-68
1 qershor 2006

Kryetari i Kuvendit të Kosovës,

Kolë Berisha